

VENDIM
Nr. 91, datë 13.5.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PAGESAT E PROKURORËVE PËR
PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT ZYRTAR”**

(ndryshuar me Vendimin nr. 49, datë 12.04.2024)

(i përditësuar)

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 11, pika 3, germa “ç”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 164, pika 8 dhe 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në nenet 4 dhe 91, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale të KLP-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për “Për pagesat e Prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje fillojnë nga data 1 Janar 2019.
3. Të njoftohen me këtë vendim “Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

RREGULLORE
PËR PAGESAT E PROKURORËVE PËR PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT ZYRTAR

Neni 1
Objekti

Rregullorja për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar (në vijim rregullorja) vendos rregulla të detajuara për kompensimin financiar ose në ditë pushimi që duhet të marrin sipas ligjit magjistratët prokurorë të cilët punojnë jashtë orarit zyrtar, ditët e pushimeve dhe festave zyrtare për shkak të shërbimit të gatishmërisë, masave të sigurimit apo çdo rasti tjetër sipas nevojave të funksionit që buron nga parashikimet e Kodit të Procedurës Penale apo ligje të tjera.

Neni 2
Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për të sanksionuar rregulla të njëjta për magjistratët prokurorë duke garantuar parimin e barazisë për punën e kryer jashtë orarit zyrtar, ditët e pushimeve dhe festave zyrtare.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në nenin 11, pika 3, germa “ç”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 189, pika 1, germa “c”, të ligjit

115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në nenet 4, 90 dhe 91, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Neni 4
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë magjistratët prokurorë të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Parimet

Parimi i barazisë: çdo magjistrati prokuror i njihet e drejta të ketë kompensim financiar ose kompensim në ditë pushimi për punën e kryer jashtë orarit zyrtar, gjatë ditëve të pushimit dhe ditëve të festave zyrtare.

Neni 6
Puna jashtë orarit zyrtar

1. Konsiderohen punë jashtë orarit zyrtar, puna e kryer ditën e shtunë dhe ditën e diel, gjatë ditëve të festave zyrtare sipas përcaktimeve të bëra në vendime të Këshillit të Ministrave dhe jashtë orarit zyrtar.
2. Kohëzgjatja ditore normale e punës konsiderohet jo më shumë se 8 orë.
3. Konsiderohet punë e kryer gjatë orarit zyrtar, puna e kryer nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Neni 7
Mënyrat e kompensimit
(ndryshuar pika 2 dhe 3 me Vendimin nr. 49, datë 12.4.2024)

1. Prokurori që ushtron funksionin jashtë orarit zyrtar, në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare përfiton kompensim financiar me shtesë page mbi pagën normale të tij ose kompensim me kohë pushimi.
2. Prokurori që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, si dhe orët shtesë të kryera në orarin 22:00–06:00, për veprime të natyrës urgjente, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.
3. Prokurori që ushtron funksionin jashtë kohës normale të punës për veprime të natyrës urgjente, përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.
4. Drejtuesi i Prokurorisë do të kompensojë financiarisht prokurorët sipas përcaktimeve në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. Në rastin e pamundësisë së kompensimit financiar atëherë prokurori do të kompensohet me kohë pushimi në rastet kur e sheh të mundur, me një pushim të paktën 25% më të madh (në rastin e orëve jashtë orarit zyrtar) që i korrespondon kohëzgjatjes së orëve shtesë dhe 50% më të madh (në rastin e punës në ditët e festave zyrtare apo pushimit javor, të shtunë ose të dielë) që jepet brenda 1 muaji nga dita e kryerjes së punës.

Neni 8

Shërbimi i gatishmërisë
(ndryshuar me Vendimin nr. 49, datë 12.4.2024)

1. Prokurori që është në gatishmëri sipas grafikut të përcaktuar nga drejtuesi i prokurorisë, për shkak të gatishmërisë gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve pushim përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi sipas pikës 4 të nenit 7.

2. Prokurori i cili është i gatshëm gjatë ditëve të javës por për shkak të gatishmërisë del jashtë orarit zyrtar të asaj dite përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi në përpjesëtim me orët e punës së kryer sipas pikës 4 të nenit 7, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.

3. Prokurori që është i gatshëm gjatë ditëve të javës, por për shkak të gatishmërisë kryen veprime në orarin 22:00–06:00, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi në përpjesëtim me orët e punës së kryer, sipas pikës 4, të nenit 7, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore, vendime të gjykatës etj.) punën e kryer gjatë këtij orari.

Neni 9

Fondet e miratuara

(shfuqizuar fjali me Vendimin nr. 49, datë 12.4.2024)

Prokuroria duhet të ketë fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të saj.

Neni 10

Dispozita kalimtare

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje fillojnë që nga data 1 janar 2019.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË